

PROCESVERBAL
nga seanca e 14-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizueleve
mbajtur më 26.03. 2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Dr. Metodija Jançeski.

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 13:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 24.03.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 24.03.2025.
3. Propozim-vendim për vazhdimin e afatit për fillimin e veprimtarisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – Shërbimi i telefonisë celulare.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.03.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.03.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Vendimin e propozuar për vazhdimin e afatit për fillimin e veprimtarisë të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë. Ai ka shpjeguar se personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova ka marrë leje për transmetim në radio në zonën e komunës së Kumanovës. Pas dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, themeluar nga kandidati në konkurs, obligohet që të fillojë kryerjen e veprimtarisë me datë 01.04.2025. Mirëpo, personi i autorizuar nga udhëheqësi i SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë ka paraqitur Kërkesë për vazhdimin e afatit për fillimin e punës, duke thënë se për shkak të tragjedisë në Koçan më 16.03.2025, si dhe anulimit të paplanifikuar të aktiviteteve të caktuara dhe obligimeve të shkaktuara nga kjo situatë e paparashikueshme janë paraqitur vonesa në përgatitjen teknike dhe programore të radios. Për shkak të këtyre rrethanave, ishte e paqartë nëse të gjitha përgatitjet do të përfundojnë deri në afatin e paraparë – 01.04.2025. Për këtë arsye është kërkuar që afati për fillimin e veprimtarisë të shtyhet deri më 03.05.2025. Z. Trajçevski theksoi se vazhdimi i afatit nuk do të ketë pasoja negative financiare për Agjencinë, sepse transmetuesit do t'i lëshohet fatura pavarësisht se radioja ende nuk ka filluar të funksionojë. Nëse Këshilli i Agjencisë nuk e miraton vazhdimin e afatit, ekziston mundësia që transmetuesi të refuzojë pagesën e faturës. Ai theksoi se praktika e deritanishme e Agjencisë në njëzet vitet e fundit ka qenë që në të gjitha rastet kur një transmetues i ri ka kërkuar anulimin e fillimit të punës, Këshilli ka marrë vendim pozitiv. Në një proces gjyqësor të mundshëm, do të ishte e vështirë të argumentohej pse këtij transmetuesi nuk do t'i miratohet vazhdimi i afatit, ndërsa të tjerëve iu lejua një gjë e tillë. Duke qenë se bëhet fjalë për anulim prej 31 ditësh, ai ka propozuar që Këshilli të miratojë kërkesën e transmetuesit. Gjithashtu, nëse transmetuesi paguan faturën, kjo do të jetë konfirmim i synimit të tij serioz për të filluar punën.

Z. Petrushevski theksoi se në Shkresë transmetuesi ka theksuar se personi teknik i obliguar për përgatitjen e pjesës teknike dhe instalimin e pajisjeve është nga Koçani dhe për shkak të tragjedisë në Koçan, që ka prekur të afërmit dhe miqtë e tij, nuk ka mundur t'i kryejë aktivitetet e planifikuara në kohë dhe në përputhje me marrëveshjen. Z. Petrushevski theksoi se do ta përkrahë kërkesën e transmetuesit, duke vlerësuar se është në interes të medias dhe të vetëqeverisjes lokale në Kumanovë.

Z. Trajçevski sqaroi se afatin për fillimin e punës përcaktohet nga vetë transmetuesi. Ai theksoi se kandidati ka mundur që në fillim të caktojë afat më të gjatë p.sh. deri në fund të vitit, por gjithashtu, nëse përgatitjet përfundojnë më herët, transmetuesi mund para afatit të parashikuar të fillojë punën dhe për këtë të njoftojë Agjencinë. Po ashtu, ai theksoi se afati për fillimin e punës nuk përcaktohet me Ligj ose nga Agjencia, por ekskluzivisht nga vetë kandidati.

Z. Fidanoski theksoi se sa herë që hapet një media e re, Agjencia si rregullator duhet të japë mbështetje. Ai pajtohet që praktika e mëparshme e Agjencisë dhe Këshillit ishte

miratimi i vazhdimet të afatit për fillimin e veprimtarisë të transmetuesve, në mënyrë që ata të mund të kryejnë të gjitha përgatitjet e nevojshme për një fillim të suksesshëm. Ai ka theksuar se Agjencia duhet të tregojë mirëkuptim si rregullator, pavarësisht nga problemet me përgatitjen logjistike të shënuara në kërkesë, të cilat rrjedhin nga tragjedia në Koçan. Në bazë të kësaj, ai deklaroi se do ta mbështesë kërkesën.

Z. Trajçev deklaroi se i kishte shqyrtuar argumentet e paraqitura në kërkesë për pamundësinë e transmetuesit për të filluar punën brenda afatit të paraparë dhe vlerësoi se arsyet që kanë të bëjnë me tragjedinë në Koçan janë objektive. Ai parashtroi pyetje Agjencisë në lidhje me procedurën për dhënien e lejes për këtë transmetues. Duke qenë se në nenin 74 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, afati për fillimin e veprimtarisë është kriter vlerësimi, pyeti nëse në konkurs ka pasur kandidatë të tjerë, nëse afati i caktuar ndikon në përzgjedhjen dhe marrjen e vendimit, veçanërisht duke pasur parasysh se neni 82 i LSHMAAV parasheh mundësinë për heqjen e lejes nëse transmetuesi nuk fillon me punë në afatin e caktuar?

Z. Trajçevski sqaroi se në konkursin për dhënien e lejes për transmetim në radio nuk ka pasur kandidatë të tjerë përveç personit fizik, që ka konkuruar si kandidat i vetëm. Më tej ai theksoi se edhe nëse do të inicohet procedurë për heqjen e lejes, fillimisht ajo duhet më 1 prill 2024 të konstatohet se transmetuesi nuk ka filluar me punë. Më pas, në afat prej tre ditësh duhet të caktohet seanca e Këshillit, pas së cilës, në përputhje me Ligjin, transmetuesi do të ketë edhe 15 ditë shtesë për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore. Nisur nga këto procedura, skadimi i këtyre afateve do të përputhej me periudhën e kërkuar nga transmetuesi për vazhdimin e afatit.

Z. Trajçev shtroi një pyetje nëse në dokumentacionin e konkursit parashikonte një afat konkret për fillimin e punës ose është caktuar nga vetë kandidati?

Z. Trajçevski sqaroi se afatin e cakton vetë kandidati në dokumentacionin e dorëzuar. Ai vlerësoi se sigurisht bëhet fjalë për mungesë eksperience, pasi kandidatët me përvojë gjithmonë parashikojnë një afat më të gjatë për fillimin e punës. Ky rast karakterizohet me një afat relativisht të shkurtër, duke qenë se vendimi për dhënien e lejes është marrë në fillim të muajit shkurt, ndërsa afati për fillimin e punës është caktuar më 1 prill 2025.

Këshilli i Agjencisë me 4 vota “pro” dhe një abstenim nga z.Trajçev, miratoi Vendim për vazhdimin e afatit për fillimin e veprimtarisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë për transmetim në radio të shërbimit programor, radio folëse-mizikore me format të përgjithshëm në të cilën llojet e programeve të përfaqësuara përmbushin dy nga tre funksionet mediatike në gjuhën maqedonase, në nivel lokal në zonën e komunës së Kumnovës.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë, obligohet që të fillojë me ushtrimin e veprimtarisë më 03.05.2025.

Në rast të mosrespektimit të afatit të lartpërmendur për fillimin e veprimtarisë, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Agjencia do të heqë lejen e dhënë para skadimit të periudhës për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbimi i telefonisë celulare. Ajo shpjegoi se është furnizim i parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2025, për të cilin mjete janë paraparë në Planin Financiar për vitin 2025 dhe shtesë do të parashihen dhe në Planin Financiar për vitin 2026. Kjo është e nevojshme sepse kontrata që del nga ky furnizim publik do të lidhet për periudhë dyvjeçare. Udhëheqësja informoi se në përputhje me shumën e planifikuar, furnizimi do të realizohet si procedurë e hapur e thjeshtuar, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Procedura do të fillojë me publikimin e shpalljes në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Ajo gjithashtu theksoi se të gjitha informatat shtesë lidhur me këtë furnizim gjenden në materialet e dorëzuara për seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: telefonisë celulare.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Shërbimi i telefonisë celulare, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht do të sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**